

**LIGJ**  
**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E**  
**LIGJIT PËR ADMINISTRIM ME PRONËN E KONFISKUAR,**  
**DOBINË PRONËSORE DHE SENDET E SEKUESTRUARA**  
**NË PROCEDURË PENALE DHE KUNDËRVAJTËSE**

**Neni 1**

Në Ligjin për administrimin e pronës së konfiskuar, dobisë pronësore dhe sendeve të sekuestruara në procedurë penale dhe kundërvajtëse (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 98/2008), në nenin 2 pika 1 ndryshohet si vijon:

“Pronë e sekuestruar”, nënkuptohet prona dhe dobia pronësore e konfiskuar përkohësisht dhe sendet e sekuestruara përkohësisht dhe prona dhe dobia pronësore e konfiskuar dhe sendet e sekuestruara me vendim të plotfuqishëm në procedurë penale dhe kundërvajtëse;”.

**Neni 2**

Pas nenit 5 shtohet titull i ri dhe nen i ri 5-a, si vijojnë:

“Statusi i të punësuarve në Agjenci

**Neni 5-a**

Të punësuarit në Agjenci kanë status të nëpunësve shtetërorë.

Të punësuarit në Agjenci të cilët kryejnë punë ndihmëse dhe teknike nuk kanë status të nëpunësve shtetërorë dhe në raport me të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e tyre nga marrëdhënia e punës zbatohen dispozitat e Ligjit për marrëdhëniet e punës, dispozitat nga sfera e sigurimit shëndetësor, pensional dhe invalidor dhe të marrëveshja kolektive.“

**Neni 3**

Në nenin 15 paragrafi 1 alineja 5 presja zëvendësohet me lidhëzën “dhe”.

Alineja 6 fshihet.

**Neni 4**

Në nenin 20 paragrafi 1 alineja 7 fjalët: “propozon dhe i zbaton” zëvendësohen me fjalët: “i miraton”.

**Neni 5**

Në nenin 23 alineja 4 fjalët: “të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e të punësuarve” fshihen.

### **Neni 6**

Në nenin 27 paragrafi 2 lidhëza “ose” zëvendësohet me lidhëzën “dhe”.

### **Neni 7**

Akti për organizimin e brendshëm dhe akti për sistematizimin e vendeve të punës në Agjenci për Administrim me Pronën e Sekuestruar, të harmonizohen me dispozitat e këtij ligji në afat prej një muaji nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

### **Neni 8**

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.